

E DIEL

3 Mars

2019



Pse u dëbua Nënë Tereza nga krerët e Kishës së Belfastit

NGA NDREK GJINI

Shenjtorja Nënë Tereza (19010-1997), sipas doku menteve të zbuluara kohët e fundit, në vitin 1973 është përzënë dhe detyruar të largohet nga Irlanda e Veriut. Këtë akt të pashembullt e ka urdhëruar mëkëmbësi i parë i kardinalit të Belfastit, Fr. Padraig Murphy.

PO SI KA NDODHUR KJO HISTORI?

Në vitet 1971-1973 Irlanda e Veriut ngjante si Shqipëria e viteve 1997-1999. Krizën tragjike dhe të vazhdueshme, që përjetoj Irlanda e Veriut në këto vite e përshkruan më se miri një raport i botuar në mars 1975 ku thuhet, 'trazirat e viteve të fundit në Irlandën e Veriut kanë shkaktuar më shumë se 1100 të vdekur dhe 11 500 të plagosur, si dhe shkatërrime pasurish që arrijnë shumën e mbi 140 milionë paundëve. Ato kishin formën herë si prishje rendi, herë si akte terrorizmi, që do të thotë dhune e

organizuar për qëllime politike apo fetare. Shumica e akteve të terrorizmit vinte nga IRA, e cila falë një organizimi të konsoliduar, përbënte një kërcënim serioz'.

Në vitin 1971, Nënë Tereza ishte një misionare e mirënjohur ndërkombëtarisht dhe e respektuar ne mbarë botën për punën e saj më të varfërit.

Kur asaj i erdhi një kërkesë për ndihmë nga prifti i zonës perëndimore të Belfastit, Fr. Des Wilson, ajo u shpreh e gatshme për të shkuar ne ketë qytet për të ndih-

muar të varfërit dhe për të kontribuar ne procesin e paqes.

Një surprize tjetër ishte ajo që Nënë Tereza jo vetëm vendosi të shkoje, por deklaroi se misioni i saj do të vendosej ne Ballymurphy - një lagje e Belfastit që ishte bombarduar vetëm dy muaj më parë dhe shkatërruar tërësisht nga dhuna e tmerrshme. Në Gusht të vitit 1971, një prift katolik dhe një nënë e tetë fëmijëve ishin midis 11 njerëzve të vrarë nga Regjimenti Parashutist në atë lagje që u bë e njohur si masakra e Ballymurphy-t

Dy shtëpi në Springhill Avenue

Në atë kohë, çdo banor veç donte të ikte nga ajo lagje, por papritur Nënë Tereza vendos që qendra e misionit të saj dhe katër murgeshat që ishin më të, të vendoseshin pikërisht në këtë lagje.

Dy shtëpi ne Springhill Avenue, pjesë e lagjes e Ballymurphy u siguruan për motrat e Misionareve të Bamirësisë.

→ Vijnë në faqen 14

A

ARGUMENT

Shenjtoria Nënë Tereza (1910-1997), sipas dokumenteve të zbuluara kohët e fundit, në vitin 1973 është përzënë dhe detyruar të largohet nga Irlanda e Veriut. Këtë akt të pashembullt e ka urdhëruar mëkëmbësi i parë i kardinalit të Belfastit, Fr. Padraig Murphy.

Pse u dëbua Nënë Tereza nga krerët e Kishës së Belfastit

NGA NDREK GJINI

Vijon nga faqja 13

DY SHTËPI NË SPRINGHILL AVENUE

Në atë kohë, çdo banor veç donte të ikte nga ajo lagje, por papritur Nënë Tereza vendos që qendra e misionit të saj dhe katër murgeshat që ishin më të, të vendoseshin pikërisht në këtë lagje.

Dy shtëpi në Springhill Avenue, pjese e lagjes e Ballymurphy u siguruan për motrat e Misionareve të Bamirësisë.

Shtëpitë ishin krejt të dëmtuara, por banorët kontribuan dhe i ringritën ato. Që në fillim, murgeshat njiheshin thjesht si "Motrat e Nene Terezës". Fr Wilson e vlerësoi lart punën e këtij 'manastiri' të improvizuar, i cili siç deklaronte ai, ngriti lart moralin e komunitetit. Të rinjtë mblidheshin në shtëpinë e motrave, këndonin, punonin, mësonin zanate të reja,

trajtimi i murgeshave nga ana e kishës u bë i patolerueshëm. Sulmet moren ngjyra dhe forma të konflikteve të hapura.

Siç duket influenca dhe emri i mirë i këtij misioni bamirësie për shtetësi dhe punët e mira që bënin në komunitet, pa përfillur dallimet politike apo fetare e kishin zbehur rolin dominant të kishës katolike. Dhe krerët e kësaj kishë nuk mund ta toleronin këtë fakt.

Përfundimisht, në vjeshtën e vitit 1973 ato i dëbuan nga Ballymurphy, më saktë i detyruan të largohen. Kisha Katolike e mohoi faktin se e kishin detyruar Nene Terezën dhe murgeshat e këtij misioni të largoheshin dhe thane që Motrat e Bamirësisë kishin ikur vullnetin e tyre të lire.



disa mësonin të lexonin dhe të shkruanin.

Kjo shtëpi e Motrave të Nënë Terezës ishte një nga vendet e pakta në atë zonë me një telefon që punonte. Dhe shpesh nënat e shqetësuara vinin për të bere ankesa apo dhe telefonata të dëshpëruara për mospagesën e përkrahjes sociale ose ankesa për anëtarët e burgosur të familjes.

Por pavarësisht se fituan zemrat e gjithë banoreve të Belfastit pa dallim nga besimet e tyre fetare, (protestant apo katolik), murgeshat nuk arritën të fitonin mbështetjen e disa klerikëve të lartë në Kishën Katolike të Belfastit.

Kishite një perceptim nga krerët e kishës katolike se puna e këtyre murgeshave ishte një turp për Belfastin, pasi krijonte idenë të të tjerët që krerët e kishës këtu nuk janë zotët t'i zgjidhin vetë problemet e banoreve të këtuashëm pa një ndihmë nga jashtë.

DËBIMI NGA BALLYMURPHY

Në fillim kundërvënja ishte e kamufuar por më kalimin e kohës

Po si ka ndodhur kjo histori?

Në vitet 1971-1973 Irlanda e Veriut ngjante si Shqipëria e viteve 1997-1999. Krizën tragjike dhe të vazhdueshme, që përjetoj Irlanda e Veriut në këto vite e përshkruan më së miri një raport i botuar në mars 1975 ku thuhet, 'trazirat e viteve të fundit në Irlandën e Veriut kanë shkaktuar më shumë se 1100 të vdekur dhe 11 500 të plagosur, si dhe shkatërrime pasurish që arrijnë shumën e mbi 140 milionë paundëve. Ato kishin formën herë si prishje rendi, herë si akte terrorizmi, që do të thotë dhune e organizuar për qëllime politike apo fetare. Shumica e akteve të terrorizmit vinte nga IRA, e cila falë një organizimi të konsoliduar, përbente një kërcënim serioz'. Në vitin 1971, Nënë Tereza ishte një misionare e mirënjohur ndërkombëtarisht dhe e respektuar në mbarë botën për punën e saj më të varfrit. Kur asaj i erdhi një kërkesë për ndihmë nga prifti i zonës perëndimore të Belfastit, Fr. Des Wilson, ajo u shpreh e gatshme për të shkuar në këtë qytet për të ndihmuar të varfrit dhe për të kontribuar në procesin e paqes.



REFIMI I EILEEN SWEENEY

Rëfimi i murgeshës katolike Eileen Sweeney, e cila punoi pranë këtij misioni, i bëri në një dokumentar të BBC, shpalos të vërtetën tragjike të këtij debimi.

Ajo tregon me imtësi sulmet e vazhdueshme që disa krerë të kishës katolike u bënin në vazhdimësi këtyre misionarëve. U trondita shumë - thotë ajo, kur një mëngjes kur shkova aty pashe që ato kishin bere gati plaçkat dhe ishin bere gati për të ikur. Pashe lotë në sytë e Nënë Terezës dhe motrave të këtij misioni. Nënë Tereza më tha shkurt - Po ikim, nuk mund të rrijmë më në një vend ku krerët e kishës katolike janë kundër nesh.

Pashë një letër të grisur në copa të vogla hedhur në dyshe. Pasi ato dolën, unë u mundova t'i mbledh dhe t'i ngjis copat e kësaj letre misterioze që i kishte detyruar këto misionare bamirësie të largohen. Ishte një letër e ardhur nga mëkëmbësi i parë i kardinalit të Belfastit, Fr. Padraig Murphy. Ai u thoshte se brenda 24 orëve duhet



të largohen nga Ballymurphy, në të kundërt do të përballeshin me pasojat e paparashikueshme.

Por jo të gjithë krerët e kishës katolike mendonin si Fr. Padraig Murphy. Një muaj pasi ato u larguan, një peticion u hartua nga famullitaret e kishave të kësaj zone. Ata vlerësonin punën e këtij misioni bamirësie në Ballymurphy. Në këtë peticion ata bënin thirrje

për një qasje të re në administrimin e famullisë, duke përfshirë krijimin e një këshilli famullitar, më një fjalë në zgjedhjen drejtuesve të ri në hierarkinë e kishës katolike të Belfastit dhe disa çështje të tjera që prekjin komunitetin lokal.

Nënë Tereza nuk e harroi kurrrë Ballymurphy-n. Një lutje në vitin 1981 ajo e falenderon komunitetin e kësaj zone për mbështetjen që i

dhane misionit të saj në ato muaj që shërbyen atje. Ajo shprehet - Ju sjell lutjen dhe mirënjohjen time për gjithçka keni bere për motrat tona, kur shërbyem atje.

NJË MONUMENT NË SHENJË MIRËNJOHJE

Kishin kaluar shumë vite nga ky dëbim i pashembullt, por si për ironi të fatit në 2010 një monument ngrihet në Ballymurphy në përkujtim të punës së vyer të këtij misioni i kryer me aq shumë devocion në ato vite të trazuara. Misionaret e motrave bamirëse u kthyen në Ballymurphy në vitin 2010 dhe pas një ceremonie mbresëlënëse bënë një fotografi para kësaj skulpture ngritur në mirënjohje të punës së tyre.

Nënë Tereza tashmë është shpallur shenjt. Ajo është pranuar si shenjt nga të gjithë - madje edhe në Ballymurphy ku dikur e patën dëbuar. Atje, ajo ka tani edhe një monument në shenjë mirënjohje të punës dhe kontributit të vyer të saj dhe motrave të misionit të saj në ato vite të trazuara për Irlandën e Veriut.

S

SPROVA

GRIGOR FUENTES

NGA BAMIR BEBEZI

Brianit i qe fiksuar se nuk do ikte nga kjo botë pa shkuar në Finca Vigía, në Kubë, për të takuar Grigor Fuentes.

Grigor Fuentes, kishte qenë miku më i ngushtë i Hemingueit për më shumë se njëzet vite; ishte kapërdan i "Pilar", i anijes së aventurave dhe personi që frymëzoi shkrimtarin për të shkruar "Plaku dhe deti".

Briani dhe Rozë ishin në mesin e shtatëdhjetave dhe bashkë kishin shtetëzuar pothuaj gjysmën e botës, por asnjëherë nuk kishin qenë në Kubë.

"Le të shkojmë e të provojmë Kubën, Rozë..." propozoi një ditë Brian.

"E çfarë do bëjmë në Kubë në këtë moshë?" përgjigjet Rozë.

"Kam dëgjuar se Grigor Fuentes feston 100 vjetorin e lindjes e me këtë rast mund të mësojmë më shumë për Heminguein."

Rozë nuk kishte kundërshtuar ndonjëherë për udhëtime, por kësaj radhe hezitonte.

"Nuk e di, sikur jam lodhur nga udhëtimet, do preferoja të shkonim diku në Florida, është më

afër."

"Njëherë feston 100 vjetorin Grigori, - thotë Briani. - Me këtë rast kalojmë edhe disa ditë në plazh."

Përfundimisht Rozë pranoi. Dita e nisjes qe një ditë e zakonshme Prilli, me një borë të imët që të thante fytyrën. Në aeroportin e Pearson-it morën avionin e linjës Toronto - Havana. Gjatë fluturimit me avion Briani ëndërronte e i dukej sikur po shkonte të takonte shkrimtarin e madh.

Pas gati katër orë udhëtimi u dukën dritat e Havanës. Kurioziteti ishte i madh, shumë mistere kishin. Komunizmi, Fidel Kastro, purorit kubaneze, bejsbolli, boksi, Huan-torena, kallam sheqeri, Besa me Mucho, Che Guevarra, Guantanamo, të lidhura me atë ishull në mes të Karaibeve, të gjitha bëheshin lësh në mendjen e tij.

Zbresin në aeroport, një ajër i ngrohtë e i lehtë sikur i ledhaton fytyrat. Një muzikë e njohur vinte diku nga larg... Guantanamo... Në doganë, Brianin dhe Rozën i

duhej të bënin foto, që mbetej pronë e vendit komunist. Kishin vizituar me dhjetra aeroporte dhe

ishte hera e dytë që duhej të bënin foto, njëherë në një vend të largët, të cilin e kishin vizituar 30 vite më parë, Shqipëria e tani në Kubë.

Marrin një autobus e drejt në Finca Vigía, të hoteli HEM-INGUEJ. Atë natë pushojnë e të nesërmen provuan për të parën herë një mëngjes kubanez, dy vezë të freskëta, të bëra me shejtësi mbi një pllakë të nxehtë nga kuzhinieri Pablo, pak djathë të bardhë dhe një kos të trashë, të cilin Rozë e pëlqeu shumë. Pas mëngjesit marrin nga një kafe të mrekullueshme, gjithë aromë e pastaj vendosin të dalin në breg. Plazhi ishte i bukur, me pak njerëz, të ulur nën disa ombrella të bëra me palma dhe një djalë kubanez, sapo i shikon, me një sy prej bakshishi, afrohet duke hapur dy shezlongë. Të nesërmen do të takonin Grigori, i cili jetonte diku në një shtëpi të moshuarish dhe një nip do ta sillte në hotel.

Te nesërmen, Briani dhe Rozë zbresin në sallën e madhe të hotelit, ku do organizohej ceremonia e ditëlindjes së Gregorit, i cili qe ulur në një kolltuk; përballë tij, mbi një tryezë të vogël qe vendosur një tortë e madhe me një qiri në mes ku

Një përshkrim për jetën dhe një elegji filozofike për përballjen, e trajtuar shumë thjesht...

DHE TE VDESESHTË ESHTË E RENDESISHME

P

POEZIA

NGA VAID HYZOTI

Përderisa loti të rrjedh në lindje,
Loti të përçjell dhe në tikje...

Dhe jeta mes lotësh-vetëm një rrëshqitje.

Dhe të vdesësh

Është e rëndësishme.
Dhe kur e di, e ndjen këtë të vërtetë,

Kupton se ke patur jetë.

*
Orë e zemrës sime
Çdo mëngjez më nis zile.
Jo për të shkuar në punë.
Ankohet se nuk e mbaj të zgjuar,
Proteston e habitet
Si vallë unë fle gjumel!
T'i shuaj zilen
S'po gjej një buton,
Te ruaj sekretin,
Mos gruaje e dëgjon.

*
Dhe sytë i hedh pas dritares,
Ku ushtarakisht parkohen dhjetra makina.
S'më hyjnë në sy dhe në është "Fer-

rari",
Asnjë markë luksoze apo e thjeshtë
S'dua të jetë e imja.
Kërkoj makinën e funeralit me shandanë,
Apo makinën e plehrave...
Si nuk vijmë?
Ku janë?
Si valle s'e ndjejnë, a punon urgjencaca?
Sinjalet e zbehta
Vazhdon të më falë zemra...

*
Po gjumi më mund, më tërheq në krevat,
Më mbulon me ëndrra, ma çmall gjithë mallin.
Krejt pa bilete me nis aq larg,
Papritur takoj nënën dhe babain.
Babai e kish lënë...paska nisur duhanin?
Nxjerr tym nga goja, apo nga damarët,
Frymën po me zinte një shtëllungje e kaltër!
E nëna më ledhaton fytyrën me gish-ta.
Bëj t'i përqafoj, por krahet s'më hapen...
I zgjuar isha...
Vazhdoja të rrëshqisja...
Tek shtëpie e vjetër
Më hodhi mërzia...

Unë-krejt i vogël,
Vazhdoja të flija.
Ja, aty në bar,
Rrëzë kumbullës së madhe.
Kokën fshehur gjoksit,
Si të jem kunadhe.
Rrëzë kumbullës së ëmbël,
Që lulonte në pranverë.
Por vit pas viti
I thahej një degë.
Derisa u tha
Dhe e preme krejt.
Në trungun e saj mbiu
Një trëndafil i egër.
Ne prapë e quanin:
Kumbulla e vjetër.
Se ish aq e mirë,
La pas dhe emër...
Zgjas duart ta prek,
Ndjej therje në zemër!

*
Kthehem në krah tjetër,
Gjumë si në përralla:
Ime bije-nuse,
Krejt në të bardha.
Gjindja e mban frymën,
Verbohen magjite.
Dielli rend të fshihet,
Veç vajza bën drite.
Hedh sytë rreth e qark,
Të kërktojë vëllanë.
E pyet me shenjë:
A e pe babanë?



shkruhej: "100 vjeç Grigor"

Grigori, i dobët e i thatë, thithte puron ngadalë e me kënaqësi. Çifti kanadez e përhëndeti Grigorin dhe biseda nisi natyrshëm. Plaku fliste ngadalë dhe kishte një shikim të çuditshëm prej të riu.

"Kush është sekret i jetëgjatësisë tuaj zoti Grigor?", e pyeti Brian.
Grigori i hodhu një shikim shpotitës dhe u përgjigj shpenguar:
"Puro kubaneze, rum kubanez dhe prostituta" e fillon të qeshë. Më pas shikon nga Rozë e i thotë:
"Të lutem më ler të uth ne faqe."

Rozë, në fillim hezitoi, pa nga i shoqi dhe ai i bëri një shenjë aprovimi. Grigori duke qeshur zgjati qafën të puthë Rozën. Briani e fiksoi pamjen në një foto të mrekullueshme: fytyra gjithë rrudha të thella e plakut, që puthte në faqe Rozën, e cila megjithëse shtatëdhjete e sa vjeçe, përsëri dukej e bukur.

Më pas, folën gjithë kohën për shkrimtarin, i cili u çonte herët për të kapur lindjen e diellit, për bejsbollin e di Maggion, për Batistën e më pas, për Fidel Kastron... U kthyen përsëri të shkrimtari i madh.

"Ka patur një jetë me shumë dhembje, - tregoi plaku. - Është rrëzuar, është vrarë, ka bërë aksidente, është djegur e në fund sëmundjet e mundën e nuk i rezistoi më dhembjeve. Vrau veten si i vëllai dhe e motra. Shkrimtari nuk kishte frikë nga vdekja. E përse të kishte? Së paku do të shpëronte nga dhembjet. Kishte edhe dhembje shpirtërore, pasi ishte një dashnor grash e pijesh pa kufizim.

"Burri, nuk është lindur për t'u mundur," thoshte shpesh Ernesto. "Një burrë mund të shkatërrohet, por jo të mundet." Në mëngjes ngrihej herët. "Përse çohesh kaq herët?", e pyesja. "Që të kem ditën më të gjatë," më përgjigje. Ëndërronte vazhdimisht. "Askush nuk duhet të jetojë i vetmuar, në moshë të vjetër," më thoshte shpesh. I pati të gjitha nga kjo botë, famën, Nobelin, gratë, por shumë pak e shihje të lumtur.

"Njerëzit inteligjentët nuk janë të lumtur," ishte një shprehje e tij e preferuar.

"Unë isha një vit më i madh se Ernesto, dhe festonim ditëlindjet çdo vit. Unë vazhdoj të festoj ditëlindjen e tij me rumin e dashur për të dy si dikur të "Pilari" i famshëm."

Koha takimit kaloi shumë shpejt, erdhi casti i fikjes së qiririt dhe të gjithë sëbashku filluan të këndonin: "Happy Birthday!"

*
Une shkyhem se qeshuri, sa me tunden brinjët,
Si mbremjeve ne lulishte, ne birre a ne kafe,
Kur si çapkene përvindim veshtrimin
Në ballkonin ku bashke rrinin dy polake.

Çdo dite falnin virgjërin me pagese,
Çdo mbremje ndenin çarçafet ne tel.
O ata çarçafë filladit pëshpërinin,
Thua se dëshirat tona na i dinin.
Tundeshin nga të qeshurat çarçafet e bardhe,
Qe sot po me ngajne me qefinin...
Dhe vazhdoj të qeshuren ta çoj gjer tek retë,
Por alarmi zemres:
Ora pesë pa dhjetet!

*
Ne kembe braf, zemres t'i bej gjyqin.
Dua akrepat t'ia bej cope.
Ajo-kokëmushkë s'e ndal alarmin,
Të më mbaje ne jete ngulmon.
Jetën qe aq shume e lodha,
Përqesha boten,
Talla vetveten.
Tani e rëndësishme është të shkoj,
Dua te ngjasoj me kumbullën e vjetër.
(Ndonëse nuk arrita te shkruaj me te mirën vepër).
Te linja dhe unë për pak kohë një emër!

*
S'më duhet më zemra, as zilja e saj,
Veç ikja tani për mua ka vlerë:
Qoftë dhe për të qenë një fillim përballë:
Na ishte dikush,
Që jetoi njëherë.

A

ARGUMENT

Ky është një artikull i autorit, që i kushtohet në një farë mënyre, karrierës dhe asaj që ai ka marrë prej saj... Jam munduar të gjej njëfarë ngushëllimi edhe te thëniet e poetëve të kohës së shkuar, të cilët mendonin se shpërblimi i vetëm për një autor është kënaqësia që i fal akti i të krijuarit, krijimtaria e tij, siç shkruan Rainer Maria Rilke: "Atëherë pranojeni fatin, mbajeni në kurriz barrën e tij, madhëstini e tij, pa kërkuar kurrë ndonjë shpërblim që mund të vinte nga jashtë.", shprehet ai

Përsiatje për veten dhe për poezinë e brezit të viteve shtatëdhjetë

NGA ANTON PAPLEKA

*Në goftë se ajo që kam shkruar ka ndonjë vlerë, atë nuk e kam unë.
Vlera gjendet aty, në vargjet e mia.
Gjithë kjo është krejtësisht e pavarur nga vullneti im. (1, 124-125)*

Fernando Pessoa

Si të gjithë fëmijët e fshatit, unë isha i rrethuar nga natyra. Më mahnitnin ndërrimet e stinëve dhe ndryshimet e motit. Sidomos gjelbërimi, lulët, fluturata dhe zogjtë...

Në të njëjtën kohë, rreth meje buiste një luzmë po aq tërheqëse legjendash, përralash, këngësh për fëmijë, këngësh lirike dhe trimërie që i tregonin njerëzit e familjes apo bashkëfshatarët. Duke i dëgjuar ato krijime gojore, më lindi dëshira t'i mësoja përmendsh disa prej tyre. Ato qenë antologjia e parë letrare që më ngjalli dëshirën për poezi.

Sot, mund të them se kjo dëshirë ka qenë diçka më tepër sesa një tekë fëmijë. Me kalimin e kohës, ajo nuk u shua, por u rënjos tek unë. Mbay mend se një natë bujtë në shtëpinë tonë një i njohur nga një krahinë tjetër: Qelloi që ai dinte shumë këngë, të cilat i tregonte me qejf. Të nesërmen, ky bujtës u detyrua ta shtynte nisjen për rrugë një copë herë, sepse unë kërkoja me të qara që ai të ma përsëriste një nga këngët e bukura që dinte, derisa e mësova përmendsh.

Shkolla fillore ma shtoi dashurinë për poezinë. Aty e mora vesh se këngët nuk përcilleshin vetëm gojë në gojë, por ato bënin jetën e tyre edhe në libra. Pasi mësova shkrim e këndim, fillova të lexoja edhe ndonjë libër letrar apo ndonjë numër të gazetës "Pionieri" që më binte në dorë. Ndër librat e parë që kam lexuar, kanë qenë "Trimëritë e Herakliut", "Aventurat e Buratinos", "Medeja". Dikush më huajti një përmbledhje të serisë "Visaret e Kombit" me këngë kreshnike, e cila ma mbushi imagjinatën me imazhe të jashtëzakonshme.

Nxijtjen e parë për të qenë më tepër sesa lexues i poezisë, ma dha mësuesi i gjuhës dhe i leximit letrar Dedë Prelë Malaj. Kur isha në klasën e gjashtë, ai më futi në rrethin letrar, sepse kisha nota të mira në lëndën e tij. Ai i porositi të gjithë anëtarët e rrethit letrar të shkruanin nga një vjershë për ta vënë në gazetën e murit. Vjersha që bëra me këtë rast, ishte një vargëzim filles-tari, por mua më dukej si një krijim magjik. Të gjitha vargjet i shkrova me shkronja të mëdha shtypi në një fletë fletoreje.

Si shumica e moshtarëve të krahinës sime të varfër e të pazhvilluar, unë nuk kisha dëshirë të vazhdoja shkollën e mesme për t'u bërë letrar, por për të shpëtuar nga varfëria, për të jetuar si ata bashkëfshatarë të arsimuar në shkollë të ndryshme që punonin si mësues, infermierë, oficerë etj.

Klasa ku bënim mësim, ishte e shtruar me dërrasa gjysmë të kalburta, të mbuluara me baltën që sillnin opingat e nxënësve kur binte shi. Njëherë, mësuesi kujdestar që hyri në klasë në kohën e pushimit të shkurtër midis dy orëve, na gjeti mua dhe dy-tre nxënës të tjerë duke lëvizur në hapësirën



para dërrasës së zezë. I inatosur nga pluhuri që ishte ngritur nga dys-hemeja, ai i mbërtheu sytë tek unë dhe më tha me zë të ashpër:

-Reaksionar! Ti nuk do të shkosh kurrë në shkollën e mesme!...

Kisha dëgjuar se në fund të vitit 1944, para se të lindja unë, një nga kushërinjtë e mi ishte vrarë pa gjyq nga forcat e komandës së vendit, i paditur nga një bashkëfshatar për mbajtje armësh të fshehta. Dy kushërimin të tjerë që rrezikoheshin të arrestoheshin nga Sigurimi i Shtetit, ishin arratisur në Jugosllavi.

Cili vlerësohet në Shqipëri?!

Në raste të tilla kam menduar se, në Shqipëri, vlerësohet e nderohet vetëm ai që është kanakar i ndonjë partie, në gjirin e së cilës e ndien veten si veshka midis dhjamat. Atij që synon të çajë udhë me talent e me punë, të krijojë ndonjë vlerë të njohur, i del përpara ledhi i pakapërcyeshëm i klaneve dhe i politikave mafioze të qeverive në fushën e kulturës. Për këto klane dhe për këto qeveri, shqetësimi për zhvillimin normal të letërsisë shqipe, për ecjen e saj së paku me hapin e letërsive të popujve fqinjë, është vrimë e fundit e kavallit...

thashë se isha jetim, kërkesa ime nuk u mor parasys. Pas këtij dështimi, u binda se për mua ato dyer ishin të mbyllura...

Me vështirësi të parrëfyeshme, në vitin 1959, mbërrita në Tiranë ku trokisa në institucionet qendrore. Në Ministrinë e Arsimit, u gjend një zyrtarë me dhembshuri njerëzore, Qibrë Ciu, e cila më ndihmoi të regjistrohesh në Shkollën Pedagogjike Dytëjeçare " Ndreç Ndue Gjoka " në Qytetin e Nxënësve, në Tiranë. Në këtë mjedis të ri, fillova një jetë të re që nuk kishte të krahasuar me jetën time të mëparshme. Shumica e

të kësaj shkolle dhe shkrimtarit të njohur Gjergj Zheji, i cili i afishoi provat e mia të para poetike në gazetën e murit " Letrari i Ri ". Më vonë, ai më shoqëroi në redaksinë e gazetës " Zëri i rinisë " dhe më ndihmoi të botoja në faqen e saj letrare. Poetët që lexoja dhe që i kisha për zemër në atë kohë, ishin Ndre Mjeda dhe Viktor Hygoi.

Pas mbarimit të shkollës së mesme dyvjeçare, u emërova mësues në një fshat të Tropojës. Në mjedisin ku punoja, poezia ishte diçka e huaj. Kushtet e jetesës nuk ishin të lehta. Krahas mësimdhënies, më duhej të jepja provimet plotësuese për të mbaruar me korrespondencë shkollën pedagogjike katërvjeçare në Shkodër. Edhe në këto rrethana nuk e ndërpreva të shkruarit e poezisë, ndonëse këtë gjë nuk e bëja në mënyrë të rregullt dhe me synime të qarta estetike.

Për mua si talent i ri, një ngjarje letrare e vërtetë qe botimi i një cikli poetik, të zgjedhur me dashamirësi nga redaktorja Liri Lubonja, në gazetën " Zëri i rinisë ", në vitin 1962. Ky botim më bëri sadopak të njohur dhe ma përforcoi dëshirën për t'u marrë me poezi.

Për t'u pajisur me një kulturë letrare më të plotë, bëra kërkesë për të vazhduar studimet e larta për gjuhë e letërsi. Për shkak të interesave të tyre meskine apo për shkak të opinioneve keqdashëse, autoritetet e rrethit më miratuan të drejtën për të studiuar për biologji-kimi në Institutin Pedagogjik të Shkodrës.

Përsëri e kërkoja shpëtimin në Tiranë. Me ndihmën e Todi Lubonjës, drejtues i rinisë, të cili e kisha njohur në konferencën e rinisë të rrethit të Tropojës, arrita të regjistrohesh në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në degën e gjuhës e të letërsisë shqipe.

Pedagogët që jepnin leksione për gjuhësinë, ishin personalitete të shquara si Eqrem Çabej, Selman Riza, Shaban Demiraj... Pa dashur të jem mosmirënjohës, jam i detyruar të pohoj se leksionet që jepnin pedagogët e letërsisë përgjithësisht ishin përshkruese, riprodhime të dispensave të përkthyer nga rusishtja. Studentët që kishin prirje letrare, mundoheshin ta pasuronin kulturën e tyre artistike me anë të leximeve individuale. Gjatë viteve të universitetit, poetët që kanë ndikuar më shumë tek unë, kanë qenë Elat Ehitmani-i dhe Janis Ricos-i, të përkthyer mjeshhtërisht nga Skënder Luarasi dhe Spiro Çomora.

Në këtë periudhë, nuk arrita të bëj ndonjë botim të rëndësishëm. E vërteta është se dyert e shtypit letrar nuk hapeshin lehtë para autorëve të rinj dhe jetën letrare e dëmtonte politika klanore.

Pas diplomimit në shkollën e lartë, përsëri u emërova mësues në një fshat të Tropojës. Për të mos u pajtuar me fatin tim prej intelektual provincial, e vazhdoja me këmbëngulje punën krijuese. Më 1971, botova përmbledhjen e parë poetike "Zëri im". Ky botim më dha zemër të ndiqja rrugën që kisha nisur: Besoj se ai ndikoi që të më transferonin në shkollën e mesme të Qytetit Bajram Curri.

Zhvillimi i përgjithshëm i shoqërisë solli

pedagogëve që jepnin mësim në këtë shkollë, kishin mbaruar studimet jashtë shtetit. Veç përgatitjes së lartë profesionale, ata rrezatonin kulturë nga mënyra sesi sillleshin me nxënësit, sesi visheshin dhe flisnin...

Rreth shkollës ku mësoja unë dhe në tërë Qytetin e Nxënësve kishte lulishte dhe parqe të bukura. Ky ndryshim i theksuar që ndodhi në jetën time, e shtyu të mugullonte farën e poezisë që fshihej brenda meje. Mbusha me vargje një fletore, e cila i ra në dorë pedagogut

gjallërimin e jetës letrare edhe në rrethim malor të Tropojës. Mendoj se kam qenë me fat që në atë kohë kam bashkëpunuar me dy poetë shumë të talentuar: S. Buçpapaj e H. Aliaj. Shtimi i krijesve nga të gjitha fushat e artit bëri të mundur që në vitin 1975, në Qytetin e Bajram Currit të krijohet dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, të cilën e drejtova deri në vitin 1983, kur u emërova në redaksinë e filmit artistik, në Kinostudion "Shqipëria e Re", në Tiranë. Gjatë asaj periudhe, kryesia e Lidhjes më ka ndihmuar vazhdimisht me leje krijuese. Autoritetet zyrtare të rrethit e kanë mbështetur krijimtarinë letrare dhe artistike. Nuk është arrestuar, nuk është nxjerrë në gjyq asnjë shkrimtar apo artist i degës së Lidhjes për Tropojën.

Për nga mosha dhe për nga koha kur kam botuar përmbledhjet e para, unë i përkas brezit që hyri në letërsinë shqipe në vitet shtatëdhjetë, në të cilin bëjnë pjesë autorë të njohur si Xhevahir Spahiu, Adem Istrefi, Koçi Petriti, Moikom Zeqo, Rudolf Marku, Agim Isaku, Skënder Buçpapaj, Hamit Aliaj. (Autorët kosovarë dhe arbëreshë të kësaj periudhe nuk kisha mundësi t'i lexoja, sepse librat e tyre futeshin në fonde të rezervuara.)

Brezi letrar i viteve shtatëdhjetë nuk i pati ato privilegje që gëzoi brezi letrar para tij: ne nuk na u dha mundësia të studionim jashtë shtetit, të mësonim me themel ndonjë gjuhë të huaj, që do të na e zgjeronte derën për të komunikuar me botën, të përvetësonim një kulturë të huaj që do të na jepte mundësi të zbulonim hapësira të reja letrare.

Pjesëtarët e këtij brezi nuk patën poste partiake dhe shtetërore, nuk patën përkrahje politike të veçantë. Për rrjedhojë, ata nuk patën as mbështetje sistematike nga masmedia e kohës, nga makina propagandistike e partisë në pushtet. Kritika letrare që zhvillohej në Shqipëri, në përgjithësi ka qenë një kritikë konformiste, e politizuar në kullm, me nivel të ulët estetik. I këtij mendimi është edhe poeti e studiuesi Dhori Qiriaz: "Në pohimet e shumicës së artikujve që shkruanin për këtë poezi nga kritika, po t'i shikosh sot, duket qartë se disa herë është marrë në mbrojtje rutina si realizimi më i mirë." (II, 29). Kritika ekzistuese u vu tërësisht në shërbim të shkrimtarëve zyrtarë, të cilët ishin shpallur si përfaqësuesit më të shquar të letërsisë shqiptare të realizmit socialist, merrnin të gjitha Çmimet e Republikës dhe u ishte akorduar titulli "Hero i Punës Socialiste".

Të shtyrë nga interesi për të zënë një vend pune apo për përfitime të tjera, këtë gjë nuk e bënë vetëm kritikët më të mëdhenj në moshë, të përgatitur në Bashkimin e Madh Sovjetik, por edhe më të rinjtë.

Autorëve të brezit letrar të viteve gjashtëdhjetë, shteti u ka dhënë një mbështetje të vazhdueshme financiare, duke krijuar hallka për përkthimin e librave të tyre dhe ka subvenconuar botimin e tyre nga shtëpi botuese të huaja.


Të imponuara nga masmedia e asaj kohe dhe nga tekstet shkollore, modelet letrare të autorëve të viteve gjashtëdhjetë ushtruan një ndikim të pasmangshëm edhe tek autorët e brezit pasardhës.

Zhvillimin normal të krijimtarisë së poetëve që hynë në letërsi në vitet shtatëdhjetë, e ndërlikoi shumë ashpërsimi i luftës së klavase që arriti kulmin në këtë periudhë. Pas Plenumit IV të Komitetit Qendror të PPSH-së që u mbajt më 1974, u zhvillua një fushatë e paparë kundër ndikimeve të huaja, e cila çoi në indeksimin e autorëve, në futjen e tyre në fonde të rezervuara. Në këtë kohë, edhe censura shtetërore u tregua më e pamëshirshme sesa asnjëherë më parë. Veç gjymtimit të librave që paraqiteshin për botim, u nxorën në gjyqe dhe u dënuan disa autorë...

Megjithatë u la në hije dhe u përball me mungesa e vështrës jashtëletrare, unë jam i bindur se brezi letrar i viteve shtatëdhjetë e pasuroi poezinë shqipe me vlera të reja substanciale dhe formale. Këtë pohim, nuk e bëj duke u nisur nga parimi i përgjithshëm se çdo brez i ri sjell patjetër diçka të re, por duke pasur parasysh disa risi, disa ar-

Brezi i viteve '70

Për nga mosha dhe për nga koha kur kam botuar përmbledhjet e para, unë i përkas brezit që hyri në letërsinë shqipe në vitet shtatëdhjetë, në të cilin bëjnë pjesë autorë të njohur si Xhevahir Spahiu, Adem Istrefi, Koçi Petriti, Moikom Zeqo, Rudolf Marku, Agim Isaku, Skënder Buçpapaj, Hamit Aliaj. (Autorët kosovarë dhe arbëreshë të kësaj periudhe nuk kisha mundësi t'i lexoja, sepse librat e tyre futeshin në fonde të rezervuara.) Brezi letrar i viteve shtatëdhjetë nuk i pati ato privilegje që gëzoi brezi letrar para tij: ne nuk na u dha mundësia të studionim jashtë shtetit, të mësonim me themel ndonjë gjuhë të huaj, që do të na e zgjeronte derën për të komunikuar me botën, të përvetësonim një kulturë të huaj që do të na jepte mundësi të zbulonim hapësira të reja letrare.



ritje konkrete, të cilat do t'i shkoqit më poshtë.

Për shkak të shkëputjes së Shqipërisë nga sfera e hegemonisë politike sovjetike, brezi im që më i çliuroi nga peshja e ndikimit të trashëgimisë sovjetike në krahasim me brezin e mëparshëm, i cili, pas shkollimit në Bashkimin Sovjetik, e zbatoi sistematikisht dogmën e realizmit socialist në vepra letrare dhe në shkrime teorike deri në fund të viteve tëndjetë. Orientimin estetik të këtij brezi, e ka shprehur fare qartë një poet që ishte njëkohësisht një personalitet i rëndësishëm i jetës kulturore shqiptare, i cili në parathënien e antologjisë ruse sovjetike, të botuar më 1959, ka shkruar: "Botimi i kësaj antologjie, pa dyshim do të jetë një ngjarje e çuar në jetën e poezisë sonë të realizmit socialist që sheh të poezia e madhe sovjetike burimin mëmë." (III, 9)

Meqenëse as dje dhe as sot, studiuesit e poezisë shqiptare të gjymsës së dytë të shekullit XX nuk i ka përdhur objektiviteti shkencor, unë do të përmend disa vlera të veçanta që sollën poetët e viteve shtatëdhjetë.

1. Krijimtaria e këtij brezi e pakësoi frymën tribunale, kolektiviste që mbizotëronte në poezinë e brezit të mëparshëm, duke e shtuar dozën e intimitizimit, duke i lënë më shumë vend botës së brendshme të subjektivitetit. E vërteta është se kjo dukuri nuk ka ndodhur vetëm në letërsinë tonë, por edhe në letërsinë e tjera europiane. Duke folur për evoluimin e poezisë suedeze të kësaj periudhe, Jacques Outin shkruan: "Bënik ndaj vetvetes dhe për këtë arsye i kritikuar nga brezi i ri i autorëve të quajtur të angazhuar, i cilësuar si mendje-

qoftë me formën, qoftë me domethënien e tij, sepse titulli dhe teksti janë në raport dialektik." (VII, 107)

Në përgjigjen që më ka çuar më 26.3.1986 për përmbledhjen "Urtia e zogjve" (më vonë titulli u ndryshua), redaksia e poezisë, e dramës dhe e kritikës letrare më bënë vërejtje veçanërisht për tematikën intime: "Në përmbledhjen tuaj ka një prirje disi të tepëruar ndaj temës intime dhe jo në pak raste mbetje në këndvështrime të ngushta vetiake, hasim përsëritje procedimesh dhe mjete gati të përafërta procedimi (me elemente natyrore etj., ose ka ekzaltime e lektisje subjektive)." (VIII)

2. Në krijimtarinë e poetëve të viteve shtatëdhjetë, vargu i lirë u bë mbizotëruar. Po të ndihmesë merr një rëndësi të veçantë, kjo të kemi parasysh se edhe ndonjë autor i brezit të viteve gjashtëdhjetë që ishte përballur me kundërshtimin e ashpër të dalzotëve të prodzisë klasike, më vonë u kthye te vargu i rregullt.

Dua të sqaroj se përdorimi i këtij apo atij vargu poetik nuk ishte thjesht një çështje teknike. Në radhë të parë, ai lidhej me mënyrën e të menduarit. Ata që kapeshin me thonj e me dhembë pas vargut të rregullt, kryesisht ishin mbrojtës të zjarrtë të realizmit socialist dhe të shtetit të diktaturës së proletariatit. Poeti zviceran Jacques Chessex e ka përqsuar prozodinë klasike me një shtet autokratik: "Një shtet i drejtuar me dorë të fortë i ngjan një poeme të përpiktë." (IX, 164) Pak a shumë, këtë ide shpreh edhe poeti danez Jorgen Nash: "Natyrisht, çdo risi është një veprim i paligjshëm kundër pyllit të gurëzuar të zakoneve të ngulitura, kundër këmishës së forcës të ideologjive të artit." (X, 118)

Për të damkosur autorët e brezit letrar të viteve shtatëdhjetë, kundërshtarët e vargut të lirë dhe të formave të reja poetike shpikën termin "prozizëm", të cilin nuk e kam hasur në asnjë libër të ndonjë esteti apo studiuesi evropian që merret me teorinë letrare. Gérard Genette-i ka përdorur termin "prozifikim", për të shenjuar me të një praktikë transtekstore, siç është kthimi në prozë i një teksti të hartuar në vargje. (Këtë praktikë ka ndjekur Mitrush Kuteli në përmbledhjen "Tregime të moçme shqiptare".)

Në një plenum të vitit 1987, njëri nga drejtuesit kryesorë të Lidhjes më kritikoi me emër si një nga mëkatat që përdornin vargun e lirë: "Por ja që edhe një nga poemat e fundit të Papelekës me titull "Valija e flakëve", në pjesën më të madhe (kësaj here duke përqsuarat thirrjet "o bir" dhe herëherë përsëritur e një fjale në disa kryeradhe rresht) mund të transkriptohej fare natyrisht, gjithashtu, si një prozë. Kemi, pra, në këto raste, një praktikë të ndërgjegjshme të fshirjes së kufijve që e dallojnë vjershën nga proza. Dukuria, pra, ekziston, emërtimi i saj mund të bëhet, natyrisht, mënyra të ndryshme. Unë e kam quajtur "prozizëm", për të mos e ngatërruar, siç po e ngatërronjë në ndonjë artikull të fundit të "Dritës" me prozaizmin..." (XI, 65)

Urretja e madhe që kishin për vargun e lirë autorët zyrtarë e dogmatikë në Shqipëri, ishte vazhdim i të njëjtës urretje që ekzistonte edhe në vendlindjen e realizmit socialist, në Bashkimin Sovjetik. Po ato kokëçarje që kanë pasur veribrastë shqiptarë, i ka njohur edhe poeti rus Vyaçeslav Kuprianov: "I konsideruar si një klasik i vargut të lirë që për një kohë të gjatë është konsideruar "disidencë estetike", tashti ai ka zënë vend në tekstet shkollore." (XII, teksti në kopertinë). Për rolin që ka luajtur në letërsinë ruse ky poet, profesor Aleksandër Lodbodanov thotë: "Për shumë kohë, ai ishte simbol i disidencës estetike në kohën e realizmit socialist." (XII, 4)

Ndryshimet prozodike që ndodhën në poezinë shqipe të viteve shtatëdhjetë, qenë pjesë e pandarë e zhvillimeve që përfshinë letërsinë e tjera europiane. Kur analizon poezinë e poetit maqedonas Bogomil Gjuzel-i, kritikun Milan Djuricinov shkruan: "Duke hedhur poshtë eufoninë dhe duke milituar për një prozoditë të re, të kuptuar si

→ Vizion nga faqja 17

një recitativ, ai zbulon mundësi të reja për gjuhën poetike." (XIII, 103)

Sipas poetit dhe filozofit Jacques Lacarrière, poetët grekë të viteve shtatëdhjetë u shkëputën nga një traditë e shkruar shumëshekullore: "Zbritja në thellësi të vetvetes, mospranimi i një mentori, braktisja pothuaj e plotë e çdo elementi metrik në të shkruarit e poemave, shkurt, nevoja e fortë dhe absolute për t'u çliruar nga çdo shtrëngesë tradicionale dhe kolektive, nga çdo përkatësi ose nënshtrim politik, filozofik apo fetar, ja çfarë e karakterizon më shumë këtë dhjetëvjeçar dhe poetët e tij." (XIV, 19-20)

Në procesin e risimit (rinovimit) prozodik morën pjesë edhe letërsitë e mëdha, siç ishte rasti i poezisë franceze, e cila kishte qenë laborator i modernitetit të poezisë botërore. Poeti dhe antologjist i njohur Henri Deluy thekson: "Kjo antologji lindi [...] Nga ndjesia që kam pasur në vitet shtatëdhjetë se aty po ndodhte diçka e re, ndoshta vendimtare për rrjedhën e poezisë sonë, për evoluimin e prozodisë sonë." (XV, 12-13)

3. Në letërsinë shqiptare, ashtu si në letërsinë e tjera europiane, në vitet shtatëdhjetë u krijuan disa grupime autorësh që kishin afërsi tematike dhe konceptuale. Këto grupime qenë qendra të vërteta poetike, të cilat ia hoqën Tiranës, kryeqytetit, monopolin si qendra e vetme e poezisë që e mbante deri atëherë.

4. Në vitet shtatëdhjetë, u shtua prania e autoreve femra, të cilat synuan të shprehnin përjetimet femërore. Autore si Natasha Lako, Feride Papeleka e Betariçe Balliçi e vazhduan me këmbëngulje itinerarin e tyre poetik, duke arritur t'i shmangeshin hegjemonisë së poezisë së krijuar nga autorët meshkuj. Ky zhvillim i ri në letërsinë tonë që pjesë e një dukurie kulturore universale, siç e tregon rasti i poezisë së Kebekut (Kanada): "Vërshimi i autoreve femra, në gjysmën e dytë të viteve shtatëdhjetë, kontribuoi në të njëjtën kohë për të shfaqur e për të përshpejtuar një ndryshim në shkrimtarinë poetike." (XVI, 33)

5. Brezi letrar i viteve shtatëdhjetë i la më pak vend tematikës së Luftës Nacionalçlirimtare, duke i dhënë pjesën e luantimit të bashkëkohore, të përditësës.

6. Megjithëse nuk e bëri dot në shkallën e dëshiruar, ai e shtoi dozën e kritikës sociale, duke fshikulluar disa dukuri negative të shoqërisë. Krahaz ngjyrave pranverore, në tablonë e jetës që paraqiti poezia, nuk muan nga ngjyrat e vjeshtës.

7. Ndryshe nga paraardhësit, ky brez e pakësoi patetizmin, hoqi dorë nga praktika sovjetike e poemave jubilarë, nuk huazoi në mënyrë mekanike elemente të jashtme, dekorative nga folklori. Duke tkurrur elementin tregimtar, përshkruues, u dha përparësi përsiatjes, metaforizmit, nëntekstit filozofik. Në rrafshin stilistik, i shmangu disa simbole tradicionale si: mali, kështjella, kulla etj. Nën ndikimin e poezisë moderne dhe moderniste europiane të përkthyer nga pjesëtarët e këtij brezi apo nga shqipëruet të tjerë, u zgjerua fusha e kërkimeve formale, ndonëse eksperimentimet qenë të druajtura dhe mbetën në faza embrionale...

8. Në krijimtarinë poetike të kësaj periudhe, gjithnjë e më shumë u mbyllën shtigjet frymës provinciale, u harmonizua më mirë kombëtarja me universalen.

9. Autorët e brezit letrar të viteve shtatëdhjetë krijuan një koncept tjetër për poetin dhe për rolin e tij në shoqëri. Ata nuk e bënë të tyre moton e poetëve të mëparshëm, të cilët deklarimin me krenari: "Dhe kanga dhe vargu asht bombë e flamur!"

10. Poetët e brezit të viteve shtatëdhjetë, kryesisht ata që rronin në kryeqytet, ndihmuan që të thellohej njohja dhe ndërveprimi midis poezisë që botohej në Tiranë dhe asaj që botohej në Prishtinë...

Ndryshe nga hulumtues të tjerë që janë ngarkuar nga struktura të caktuara për të bërë hulumtime selektive në Arkivin e Shtetit, për t'i shërbyer ndonjë autori të veçantë, Dashnor Kaloçi ka botuar doku-



Përsiatje për veten dhe për poezinë e brezit të viteve shtatëdhjetë

mente që dëshmojnë se në shënjestër të censurës zyrtare, të kritikave të aspra të forumeve partiake dhe të organizmave shtetërorë, kanë qenë posaçërisht autorët e brezit të viteve shtatëdhjetë. Ky hulumtues ka botuar Raportin sekret "Disa probleme të pastërtisë së përmbajtjes së krijimtarisë letrare e artistike", të mbajtur nga Mehmet Karakushi në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH-së, më 24 mars 1980. Aty thuhet: "Gjatë vitit 1979 u kthyen pesë vëllime të autoreve me përvojë Agim Gjakova, Agim Isaku, Rudolf Marku, Ndoc Papeleka etj., mbase një pjesë e vjershave kishin gabime ideore, në prirje formaliste, ose ishin të paqarta dhe krijonin keqkuptim." (XVII, 10-11).

* Megjithëse kam qenë një nga ata autorë që kanë bërë përpjekje për të praktikuar forma të reja shprehjeje, jam i vetëdijshëm se tekstet e mia, të botuara në vitet shtatëdhjetë e tetëdhjetë, kanë pasur dobësi që nuk lidheshin vetëm me shkallën e talentit tim apo me postulatën e njohur se "Çdo poemë është një copëz e asaj që nuk mund të thuhet." (XVIII, 15)

Tek unë ka ndikuar censura e institucionizuar, të cilës i nënshtroheshin botimet letrare të asaj kohe. Vetëm librat e autoreve që kishin përkrahje të veçantë politike, që mbanin poste partiake dhe shtetërore, përgjithësisht botoheshin ashtu siç paraqiteshin në redaksi. Për autorët e tjerë, sidomos për autorët nga rrethet, botimi i një libri ishte vërtet një punë Sizifi. Dëshkrimet e tyre gjymtoheshin, ndrysho-

heshin, tjetërsoheshin deri në atë shkallë, sa që libri i botuar pothuaj nuk ngjante me dorëshkrimin e paraqitur në redaksi.

Në rrethana të tilla, autori kishte përpara dy alternativa: të hiqte dorë nga të botuarit ose të pranonte të ishte viktimë e censurës. Për këtë dilemë hamletiane, poeti francez E. Guillevic-u është shprehur: "Vallë, çfarë të shkakton më shumë dhimbje: / Të mos mund të këndosh/ Apo të këndosh me detyrim?" (XIX, 355)

Ata që i kërkohjën më shumë të metat, politizimit në krijimtarinë time të kohës së diktaturës së proletariatit, as që duan t'ia dinë se, përveç censurës zyrtare, autorët kërcënoheshin edhe nga lufta e klasave në jetën e përditshme. Në vitet shtatëdhjetë, ndonjë bashkëfshatar imi i bënte letra Komitetit të Partisë të rrethit që të më hiqte nga puna si mësuës për shkak të biografitë politike të keqe. Për të njëjtin motiv, ndonjë kuadër dogmatik i Qytetit Bajram Curri i kërkonte Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve e të Artistëve të Shqipërisë të mos më pranonte si anëtar të kësaj organizate.

Kisha ardhur në jetë dhe rroja në një regjim politik që nuk e kisha zgjedhur unë. Në kushtet e një lufte klasash që shndërrohej në luftë për ekzistencë, i shtyrë nga instinkti i vetëmbrojtjes, e kam shtuar dozën e angazhimit e të entuziazmit. Sigurisht, kjo gjë ka ndodhur edhe nën ndikimin e klimës politike dhe artistike të shoqërisë ku rroja. Në atë kohë, unë nuk e shihja anën e padukshme të shoqërisë, sepse informacioni ishte i mangët: nuk kishte si sot njëqind parti, njëqind gazeta, njëqind radio dhe njëqind stacione televizive. Kryesor-

ja ishte se nuk kishte liri shprehjeje.

Duke folur për lidhjen midis poetit dhe shoqërisë ku bën pjesë ai, Antonio Tabucchi thotë se mendimi i Leopardit është prodhim i një epoke kulturore. (XX, 94) Për ndikimin e kushteve politike dhe shoqërore mbi poezinë, H. Deluy shkruan: "A është e nevojshme të themi se nuk ka poezi jashtëkohore? Se poetët nuk janë duarjashtë në çështjet e kësaj bote?" (XIV, 15) Madje edhe shkrimtari i njohur Philippe Sollers, i cili në këtë periudhë rronte në mes të Parisit dhe nuk kishte mbi kokë shtatën e Damokleit që quhej lufta e klasave, pohon në kujtimet e tij se në një çast të caktuar është tunduar nga frazeologjia revolucionare. (XXI, 396) Pikëpamjet e autoreve që përmenda më lart, nuk i parashtrua për të shfaqësuar veten, por për të shpjeguar një dukuri që ka ekzistuar...

Megjithatë edhe sot e kësaj dite, mendoj se ndërtimi i Hidrocentralit të Fierzës ka qenë një kantier madhështor e heroik, se elektrifikimi i vendit ka qenë një ndryshim epokal për mua që e kisha kaluar femijërinë në dritën e pishës e të kandilit. Në një kohë kur ende nuk flitej për ekologjinë, industrializimi i vendit më dukej si një dëshmi progresi. Kjo gjë ka ndodhur edhe me disa autorë europianë, siç është rasti i poetit danez Johannes V. Jensen-i (Çmimi Nobel për Letërsi më 1944): "Ndonëse i heshtur, pranimi i botës industriale anglo-saksone nga Johs V. Jensen ka disa arsye. Midis të tjerave, ai mund të duket si një bashkim i domosdoshëm me progresin." (X, 13) Disa studiues të letërsisë e kanë parë industrializimin të lidhur ngushtë me avangardat letrare: "Mirëpo ligjërimi për automobilin do të na shtyjë pashmangësisht të përmendim problemën e makinës në përgjithësi, çka është, siç dihet, një temë e privilegjuar në

...nga numri i shkuar

"Milosao" e kësaj jave mund të quhet relativisht e mirë dhe e këndshme. Shkrimi kryesor iu la kujtimeve të një aktori të botës gjermanike për kolegun e tij të njohur me origjinë shqiptare Aleksandër Moisi. E kishte sjellë Pjetër Logoreci që ishte deri në fund shumë i mëdysuar për performancën e këtij shkrimi. U munduam t'i japim mbulim të madh, por që nuk u prezantua aq mirë në fund në faqen e parë. Redaktori respektoi timbrin geg të shkrimit por edhe pasqyrimin e autorit, për kujtimin e personazhit të tij. "Ma në fund më erdhi mundësia që të kem një rol, por një rol të vërtetë, në dramën e Gerhart Hauptmann "Shpëtimtari i Bardhë", që ishte në repertorin vijtor të Teatrit Popullor të Vjenës. Kjo dramë ishte zgjedhur nga drejtuesit e teatrit vetëm për shkakun se roli kryesor, ai i mbretit të Aztekëve, Montezumës, një rol që erdhi në këtë teatër si shkollë e plastikës, interpretohej nga Aleksander Moisiu, që ishte ylli e ma i njohuni i ditës. Vetëm mendimi se do të ndodhesha në skenë përballë gjigandit Aleksander Moisiu, se do ta kem partner, ishte emocionimi më i madh në jetën time të sapo fillueme teatore. Në të vërtetë roli im ishte vetëm një frazë, por një frazë në vargje dhe tepër e gjatë. Siç ishte zakoni të "trajtoheshin" asokohe aktorët e rij, një ditë para premierës, një asistent i regjisorit u muer pak çaste me mua, tuj më "mësue" që bauten ta thojsh me ton të naltë, gati si ulurim".

Studiuesi i njohur Leonard Zissi na ka sjellë një fakt të njohur, por gjithsesi interesant, për basoreleivin e Skënderbeut në Gdansk, që ishte trajtuar me shumë respekt dhe skrupulozitetin e zakonshëm të autorit. Autori ishte i pezmatuar që nuk u botua më parë, por me edukatën e tij e kaloi me shumë qytetari vonesën.



Dr. Jorina Kryeziu na kish sjellë një intervistë me përkthyesin izraelit të gjuhës shqipe Rami. Intervista ishte trajtuar shumë profesionalisht por pak ftohtë për lexuesin, që nuk është i lidhur me letërsinë. Duhet vlerësuar autorja për seriozitetin me të cilin punon. Znj. Kryeziu ishte në ankth deri në fund për performancën dhe botimin e tij.

Petra Risto na kish sjellë një cikël poetik me një figuracion interesant për artikulimin e tij. Frymëzimin artistik e ka si gjendje të vazhdueshme, që e ushqen me një vëzhgim interesant të nënvetëdijës dhe botës që e rrethon, shkroi redaktori, që mori dhe një feedback të mirë prej tij.

Arkitekti Andi Papastefani është duke skicuuar Tiranën e harruar, atë që sot fshihet nga ndërtesat shumëkatëshe dhe ndërtime të shumta pa kriter. Në këtë numër, i botuam pak vizatime të tij, bashkë me një sqarim, ku ai flet për një teknikë ndërtime, me të cilën identifikoheshin shumë objekte në Tiranë.

Vetë redaktori shkroi një shkrim Bashkim Hoxha, që e cilësoi si një rrëfimitar të këndshëm dhe një autor që e njezh mrekullisht dialogun. Kjo i jep lehtësinë që çdo temë mund ta zbrëthëjë lehtësisht. Kështu ka ndodhur dhe këtë herë me gjuhëndjet interesante në vepër të personazheve por edhe përshkrimin për metamorfozat e çuditshme. Evolucionit i personazheve duket sikur i paraprin kohëve, por në fakt janë këto të fundit, që autori i ndjell përpara personazheve të tij... Bashkimit nuk i pëlqeu një vërejtje në formë këshille, por gjithsesi shkoi. Mund të themi se ishte numër i mirë por pa shumë befasi, gjithsesi i këndshëm të lexohet në këtë kohë krize. Layout punoi shumë mirë.

HISTORI

Shqiponja jonë, e cila sipas ligjit duhet të ketë në krahë 9 pendë dhe në bisht shtatë pendë, duket krejt e modifikuar dhe si një shpend jo i zakonshëm në simbolikën e institucioneve zyrtare. Kjo sot nuk është më normale, por shqetësimi është se për debatin nuk flasin profesionistët...

Për shqiponjën, si ta duam?!

NGA BEN ANDONI

Gjëja më 'argëtuese' e ditëve të përvjetorit të pavarësisë ishte momenti kur u shfaqën flamujt e vegjël. Nga një hulumtim i atyre ditëve u zbulua se shumë prej flamujzave ishin prodhime me origjinë kineze. Ndërsa për një pjesë kjo ishte fatale, justifikimi i shumë të tjerëve ishte shumë pragmatik. Kineze mbajnë markën dhe shumë simbolika të suvenirëve, por edhe objekte edhe në vendet më të zhvilluara, madje edhe simbole thellësisht historike, kështu që nuk kishim pse të habiteshim. Vetëm se këleka ishte dikund tjetër: shumë prej simbolikave tona, prodhuar nga kinëzët, ishte të shpërfytyruara.

Pak muaj më pas, do të vinte radha e simbolikës së shqiponjës në një nga dikasteret tona. Ajo do identifikohet direkt me shqiponjën sllave. Në fakt, shqiponja duket e stilizuar shumë ndryshe dhe pothuaj kishte humbur karakteristikat e shqiponjës me të cilën ishte mësuar syri i shqiptarit të thjeshtë dhe që identifikonte simbolin kryesor kombëtar.

Kjo qëllon gati e tmerrshme. Filuan interpretimet e çfarëdoshme, për pozicionin e krahëve, kokën, pendët, kthetrat dhe lloj-lloj hipotezash. Ngjyrat u bënë vrastare. Bizanti u përzje me Kombin, Shqipëria me Arbërinë, u shanë politikanët u tregua patriotizmi...Fitoi kakofonia.

Luan Rama, deputet i Lëvizjes Socialiste për Integrim, iu kthye sërish ditë e fundit dhe me një kulturë të admirueshme e parashtrij defektin, sipas tij, duke kërkuar përgjegjshmëri, kurse kohë më parë denoncoi përdorimin e shqiponjës me ngjyrë të bardhë, në simbolin kombëtar të përdorur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Por, ai shkoi edhe më tej, kur tha se kjo përbënte një shkelje të rëndë të kushtetutës, duke gjykuar për veprimin e insti-



tucionit të MEPJ.

Në fakt, modifikimi i shqiponjës ishte gati i dhimbshëm për një grup ndërkohë mijëra flamuj të tillë syresh valëviteshin ditë e përvjetorit të pavarësisë.

Asokohe, t-shirtet, shallet dhe kapelet, por jo vetëm, u mbushën me këtë simbol shqiponje që devijonte paq. Por habia shkoi më tej në një interpretim që bënte dhe njerëzit e kampit tjetër politik, ku shqiponja e përdorur prej tyre i ngjante asaj të Stefan Dushanit

Shqiponja jonë, e cila sipas ligjit duhet të ketë në krahë 9 pendë dhe në bisht shtatë pendë, duket krejt e modifikuar dhe si një shpend jo i zakonshëm, me atë që i diktojnë institucionet shqiptare. Kjo sot nuk është më normale. Pak kohë më parë, historiani Pëllumb Xhufi parashtrij idenë e tij për shqiponjën e flamurit, por shtoi me maturi se nuk duhet ekzagjeruar: "Ne kemi shqiponjën më të bukur, se nuk jemi të vetmit që kemi shqiponjën me dy krerë. Ne e kemi marrë në një formë që nuk puqet fare as me sllavët, as me gjermanët, as me austriakët, as me serbët e malazezët e as me rusët. Shqiponja është një simbol që mjedisin e natyrshëm e ka tek flamuri. E ka cilësuar Barleti, për shqiponjën në



flamurin e Skënderbeut. Ky flamur i cikluar në epokën e Rilindjes. Ata e rindërtuan, e reformuluan flamurin në bazë të thënies së Barletit dhe bëjnë një shqiponjë të shkëlqyer. Që nga ajo e shoqatës Vatra, Drita janë shqiponja të bukura, të zeza dhe me krahët e hapur, të shpalosur, dinamike po krejt e veçantë".

Në fakt, specialisti do të shton se shqiponja mund të interpretohet në mënyra të ndryshme, goftë edhe prej materialit ku përdoret por edhe elementëve të tjerë, por ngjyra nuk ndryshon, ndaj duhet të ishim të kujdesshëm...

...Në Shqipëri është një heraldikë e njohur por krejt në hije tashmë. Vitë të shkuara, Gjin Varfi bëri



Për Gjin Varfin

Në Shqipëri është një heraldikë e njohur por krejt në hije tashmë. Vitë më parë, Gjin Varfi bëri dhe një botim interesant për heraldikën shqiptare, por veç pritisë së mirë atëkohë, nuk pati asgjë më vonë, që ta vlerësonte këtë investim të tij.

I lënë krejt në hije, sot, ai nuk thirret edhe kur përgatiten simbolika apo stema nga institucione apo me shumë akoma është marrë dhe lënë krejt jashtë diskutimeve. Shqetësues është se ka shumë institucione që kanë bërë modifikime simbolikash por që asfare nuk e kanë reflektuar duke pyetur për mendim të specialistit. Dikush, në rastin e Varfit, mund të përdorë kundër tij shkollimin e ngushtë, apo faktin që është i lidhur në një fushë krejt tjetër, anipse askush nuk i është dedikuar si ai heraldikës, por edhe interpretimit.

dhe një botim interesant për heraldikën shqiptare, por veç pritisë së mirë atëkohë nuk pati

asgjë më vonë, që ta vlerësonte si duhet këtë investim të tij.

I lënë krejt në hije, sot, ai nuk thirret edhe kur përgatiten simbolika apo stema apo me shumë akoma është marrë dhe është lënë krejt jashtë, thjesht duke e justifikuar se iu mor mendimi. Shqetësues është se ka shumë institucione që kanë bërë ndryshime simbolikash por që asfare nuk e kanë reflektuar duke pyetur për mendim të specialistit. Dikush, në rastin e Varfit, mund të përdorë kundër tij shkollimin e ngushtë, apo faktin që është i lidhur në një fushë krejt tjetër, anipse askush nuk i është dedikuar si ai heraldikës, por edhe interpretimit.

Duhet të përmendim se heraldika duhet të ketë dhe një lloj uniteti, gjë që nuk ndjehet në morinë e simbolikës të re shqiptare. Një gjë e tillë ndodh shpesh, dhe pothuaj e hasim në të gjitha fushat, por kjo na bën të kujtojmë shqetësimin e madh, që sa pak e dëgjojmë mendimin profesional dhe jo vetëm. Kjo të vintë ndër mend kur artikulet të ndryshëm shtronin idenë e shqiponjës në simbolin tonë dhe specialistë si Gjin Varfi heshtnin...sepse askush nuk kujtohet kurrë për ta. (Milosao)